

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot miratojmë një marrëveshje që synon financimin e përbashkët të projektit madhor në albanologji “Enciklopedia shqiptare”, që do të zbatohet nga Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipëria dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Republikën e Kosovës. Pak ditë më parë ne festuam një përvjetor të rëndësishëm për historinë e kombit shqiptar, festuam 114-vjetorin e Kongresit të Manastirit, ku u vendos unifikimi i alfabetit të gjuhës shqipe. Sot, pas 114 vjetësh, përtej detyrimit që kemi të gjithë së bashku për ruajtjen dhe forcimin e gjuhës shqipe, jemi krenarë që ky përvjetor na gjen me arritje të mëdha. Në shtator përruam abetaren e përbashkët, unike për të gjithë vogëlushët shqiptarë në Shqipëri dhe në Kosovë.

Një vit më parë botuam “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare 1” në diasporë dhe po punojmë për botimin e dytë. Ndërkohë, kemi unifikuar kurrikulat, u kemi dhënë të drejta të barabarta studentëve nga Kosova për të studiuar në universitetet tona dhe kemi bërë edhe shumë marrëveshje e projekte të tjera të përbashkëta. Por një ndër projektet më madhore të përbashkëta është “Enciklopedia shqiptare”, që do ta miratojmë sot. Kjo vepër do të paraqesë personalitete, ngjarje historike, politike, kulturore, sociale dhe ushtarake nga e gjithë hapësira kombëtare shqiptare, por edhe dukuri e personalitete të huaja me kontribut në promovimin ndërkombëtar të identitetit kombëtar, të promovimit të gjuhës, kulturës, traditës, trashëgimisë dhe historisë, si dhe në mbrojtjen e çështjes kombëtare në arenën ndërkombëtare.

Në prag të festave të nëntorit, në kuadër edhe të 110-vjetorit të pavarësisë, ky projektligj, kjo marrëveshje merr një vlerë edhe më të madhe, për të cilën do të krenohet nesër i gjithë kombi shqiptar. Ndaj unë ju ftoj ta mbështesim jo vetëm me votë këtë projekt, por edhe me bindje të plotë, sepse kjo enciklopedi është kontribut jo vetëm në fushën e albanologjisë, por shumë më tepër se kaq, për Shqipërinë dhe për Kosovën. Faleminderit!